



Komunitete inkluzive
për të rinjtë



2023



RAPORT MONIITORIMI

RAPORT MONITORIMI PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR
PJESËMARRJE RINORE DHE POLITIKA RINORE
NË RAJONIN E VARDARIT



Funded by
the European Union



National Youth Council
of Macedonia



ФОНДАЦИЈА
ЗА РАЗВОЈ НА
ЛОКАЛНАТА
ЗАЕДНИЦА



LOCAL
COMMUNITY
DEVELOPMENT
FOUNDATION

BOTUES:

Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë
Rr. Veljko Vlahovi,, nr. 7 / 1-1, 1000 Shkup
www.nms.org.mk
info@nms.org.mk

RRETH BOTUESIT:

Filip Ivkovski, u.d. kryetar

AUTOR DHE REDAKTOR

Filip Kulakov

BASHKËPUNËTORË

Mariana Angelova, Nevenka Longurova Girova, Aleksandar Mihajloviq, Ana Naumoska, Dea Zdravkovska, Dejan Petrovski, Ivana Atanasovska, Ivana Haxhi-Nikollova, Jordanço Minevski, Kristijan Panev

LEKTURË

Valentina Joshevska

DIZAJNI

Andrej Badjukov

VITI I BOTIMIT

2023

Ky raport monitorimi është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Këshillit Rinor Nacional të Maqedonisë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

RRETH PROJEKTIT

Objektivi kryesor i projektit “Komunitete gjithëpërfshirëse për të rinjtë” është angazhimi i organizatave rinore të shoqërisë civile për të ofruar mbështetje për komunitetet e tyre lokale, për të përdorur mekanizmat ekzistues për pjesëmarrje në politikat lokale dhe proceset vendimmarrëse, të cilat i referohen nevojave të tyre dhe nevojave të zgjedhësve të tyre.

Aktivitetet kryesore të projektit përfshijnë: forcimin e kapaciteteve të organizatave rinore dhe këshillave rinore lokale përmes një serie punëtorish, monitorimin e zbatimit të Ligjit për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, vlerësimin e përfshirjes së të rinjve në vetëqeverisjet lokale në Maqedoninë e Veriut, hartimin e rekomandimeve të politikave dhe mbështetjen e iniciativave të avokimit rinor që rrisin pjesëmarrjen e të rinjve në politikën publike.

Projekti zbatohet nga Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë, së bashku me partnerët Fondacioni për Zhvillimin e Komuniteteve Lokale – Shtip, SFERA International Manastir dhe Platforma për Fuqizim Rinor JEP – Gostivar. Projekti “Komunitete Gjithëpërfshirëse për të Rinjtë” mbështetet nga Bashkimi Evropian

RRETH PARTNERËVE

KËSHILLI RINOR NACIONAL I MAQEDONISË

Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë (KRNM) është një platformë që përfaqëson interesat dhe nevojat e të rinjve si lidhje ndërmjet të gjitha palëve të interesuara dhe siguron përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve në procesin e vendimmarrjes në çdo nivel. KRNM është themeluar më 29 qershor 2013 nga 55 organizata.

KRNM është organ përfaqësues i organizatave rinore në Maqedoninë e Veriut. Këshilli bashkon aleanca, organizata rinore, organizata rinore dhe forume rinore të organizatave të tjera me qëllim të promovohen dhe përfaqësohen të rinjtë dhe të drejtat e të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Anëtarësia e KRNM-së është e larmishme, duke bashkuar organizata që veprojnë në nivel kombëtar dhe rajonal, në zonat rurale dhe urbane, organizata studentore, degë të organizatave ndërkombëtare dhe lloje të tjera shoqatash. Në procesin e arritjes së qëllimeve të tyre, KRNM përfaqëson interesat e të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut pavarësisht nga statusi i tyre socio-ekonomik, gjinia, raca, prejardhja etnike dhe kulturore, bindjet politike dhe fetare, orientimi seksual, identiteti gjinor apo çdo formë tjetër.

FONDACIONI PËR ZHVILLIMIN E BASHKËSISË LOKALE

Fondacioni për Zhvillim të Bashkësisë Lokale Shtip (FZhBL) është themeluar në dhjetor të vitit 2006 dhe është pasardhës ligjor i OJQ-së Qendra për mbështetje Shtip. Misioni i FZhBL-së, është pjesëmarrja efektive e qytetarëve në krijimin e politikave publike dhe zbatimin e tyre të qëndrueshëm. FZhBL-ja, ka krijuar bashkëpunim të mirë me organizatat e shoqërisë civile nga Maqedonia, institucionet lokale dhe kombëtare, komunitetin e biznesit dhe mediat.

Donatorët vendas dhe të huaj janë partnerë të FZhBL-së, në mbështetjen e zhvillimit të shoqërisë civile në Maqedoni dhe promovimin e parimeve të sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë. Fondacioni punon në mënyrë aktive në sektorët e decentralizimit, qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, lobimit dhe avokimit, të drejtave të njeriut, transparencës dhe llogaridhënies, promovimit të filantropisë, etj.

Aktivitetet e Fondacionit përdoren nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, institucionet lokale dhe shtetërore, sektori i biznesit, të rinjtë aktivë, media dhe donatorët.

SFERA INTERNACIONAL

Shoqata për Zhvillim të Qëndrueshëm SFERA INTERNACIONAL – Manastir u krijua në vitin 2009, e cila fokusohet tek të rinjtë dhe të gjithë qytetarët në komunën e Manastirit për të arritur qëllimet, aktivitetet dhe veprimet kryesore në suazat e misionit tonë, që është ngritja e vetëdijes dhe edukimi i komuniteteve lokale përmes metodave arsimore joformale, në tema të tilla si mbrojtja e mjedisit, trashëgimia kulturore dhe natyrore, jeta e shëndetshme, qëndrueshmëria afatgjatë e zhvillimit të të rinjve dhe pjesëmarrja aktive e të rinjve përmes vullnetarizimit në Maqedoninë e Veriut.

Vizioni i SFERA INTERNATIONAL është një mjedis i pastër, ekologjik në Republikën e Maqedonisë së Veriut me përdorim të burimeve alternative të energjisë.

SFERA INTERNATIONAL përmes arsimit joformal inkurajon praktikën e jetesës së shëndetshme, kujdesin për mjedisin, pjesëmarrjen aktive të të rinjve në RMV-së dhe vullnetarizmin.

PLATFORMË PËR FUQIZIMIN E TË RINJVE

Platforma për Fuqizimin e të Rinjve – JEP, u krijua në vitin 2015 që përpiqet të mbështesë të rinjtë nga Gostivari dhe zona përreth përmes kultivimit të aftësive të tyre drejtuese, duke inkurajuar angazhimin e tyre qytetar dhe duke siguruar aftësi teknike.

Misioni i JEP është të inkurajojë dhe fuqizojë të rinjtë përmes projekteve të ndryshme. Qëllimi ynë është të frymëzojmë dhe trajnojmë të rinjtë për të marrë një rol aktiv në procesin e vendimmarrjes.



PËRMBAJTJA

LIGJI PËR PJESËMARRJE RINORE DHE POLITIKA RINORE	7
RAJONI I VARDARIT	10
KËSHILLA RINORE LOKALE	11
STRATEGJI LOKALE PËR TË RINJ	11
NËPUNËSIT RINOR	11
ZYRA RINORE	12
QENDRA RINORE	12
FINANCIMI	12
KONKLUZIONE	13
REKOMANDIME	15

LIGJI PËR PJESËMARRJE RINORE DHE POLITIKA RINORE

Në vitin 2018, me iniciativë të Klubit për çështje dhe politika rinore në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, filloi procesi për krijimin e Ligjit për të rinjtë. Prosesi vazhdoi për herë të dytë, pasi në vitin 2011 nga shteti, me kërkesë të sektorit të rinisë, propozim - ligji i atëhershëm për të rinjtë u tërhoq.

Në nivel kombëtar, gjatë procesit të krijimit të ligjit, u formua një grup pune ekspertësh i përbërë nga përfaqësues të sektorit të të rinjve, me qëllim që të kontribuojë në krijimin e përmbajtjes së ligjit, bazuar në përvojat e tyre të punës me të rinjtë në nivel kombëtar dhe lokal. Grupi punues i ekspertëve përfshinte deputetë të pozitës dhe opozitës, përfaqësues të forumeve rinore të partive politike dhe përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare. Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë mori pjesë me pesë përfaqësues, të cilët përfaqësonin interesat e organizatave anëtare të Këshillit. Gjatë këtij procesi, Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë me mbështetjen e organizatave të tij anëtare dhe Bazës së trajnerëve të KRNM-së, realizoi 17 konsultime me të rinjtë në nivel lokal me qëllim të përcaktimit të nevojave të të rinjve për atë që ata dëshirojnë të zbatohet me Ligjin e ri për të rinjtë.

Më 14 janar 2020, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Ligjin me titull “Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore”.

Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politika rinore është zgjidhja e parë ligjore në Maqedoninë e Veriut që garanton pjesëmarrjen e të rinjve dhe njeh të rinjtë dhe format e organizimit të të

rinjve. Si i tillë, Ligji bën dallimin ndërmjet një organizate rinore, një organizate për të rinjtë dhe një organizate ombrellë rinore, dhe delegon detyrimin e Agjencisë për Rini dhe Sport për të mbajtur një Regjistër të formave të organizimit rinor. Ligji gjithashtu për herë të parë përcakton se çfarë është person i ri, politika rinore, pjesëmarrje rinore, punë rinore dhe punëtor rinor.

Për sa i përket pjesëmarrjes rinore, ligji parashikon mekanizma në nivel kombëtar dhe lokal për përfshirjen e të rinjve në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes, përkatësisht Trupin Këshillimor Kombëtar për Politika Rinore dhe këshillat rinore lokale në të gjitha komunat.

Nga aspekti i politikave rinore, në vetë Ligjin është përfshirë miratimi i strategjisë kombëtare për të rinjtë dhe strategjitë lokale rinore, si dokumente strategjike kryesore për aktivitetet rinore të cilat i planifikojnë dhe zbatojnë institucionet dhe komunat. Strategjia Kombëtare për të rinjtë është një dokument strategjik që përcakton synimet dhe prioritetet afatmesme për zhvillimin e politikave rinore dhe promovimin e interesave të të rinjve dhe miratohet brenda një periudhe pesëvjeçare. Strategjia lokale për të rinjtë është një dokument strategjik i cili, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për të rinjtë, përcakton synimet dhe prioritetet afatmesme për zhvillimin e politikave rinore dhe promovimin e interesave të të rinjve në nivel lokal.

Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore parasheh edhe shërbime rinore, gjegjësisht mekanizma për afrimin e institucioneve për të rinjtë dhe mundësimin e rritjes dhe zhvillimit të tyre. Si të tillë, në kuadër të Ligjit janë përkufizuar zyrat për qendrat rinore, ndërsa në kuadër të institucioneve shtetërore është paraparë që të caktohet nëpunës për të rinjtë, përkatësisht një person përgjegjës për funksionimin e zyrës rinore të lartpërmendur, si dhe për koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e çështjeve me interes për të rinjtë në fushëveprimin e kompetencave të institucionit. Në kuadër të kapitullit Shërbimet për të rinjtë, Agjencia për Rini dhe Sport pritet gjithashtu të krijojë qendra kërkimore për tema të lidhura me rininë.

Dhe në fund, sa i përket financimit për zbatimin e këtij ligji, nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut ndahen çdo vit mjete në vlerë prej së paku 0,3%, ndërsa nga buxhetet e komunave për të rinjtë ndahen mjete në shumën prej të paktën 0,1% në vit.

Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politika rinore, në formën në të cilën është miratuar, mbulon shumë përfitime për rininë dhe organizatat rinore në Maqedoninë e Veriut, por lë hapësirë për zgjerimin dhe promovimin e tij, veçanërisht në drejtim të krijimit të mekanizmave për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit në nivel qendror dhe komunal dhe sigurimin e cilësisë së mekanizmave të parashikuar për pjesëmarrjen rinore dhe shërbimet rinore, si dhe për njohjen e KRNM-së, si Këshill Rinor Nacional, që është praktikë në vendet evropiane, me qëllim shfrytëzimin e kapaciteteve dhe praktikave ekzistuese të krijuara përmes KRNM-së për të krijuar politika rinore më të mira dhe cilësore.


Tre vjet nga miratimi i këtij ligji, në prill 2023, u mbajt një debat publik mbi Ligjin për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, i cili diskutoi se cilat aspekte të ligjit funksionojnë dhe cilat jo – për të përcaktuar se ku është nevoja për ndryshime në ligj.





RAJONI I VARDARIT

Rajoni i Vardarit përfshin nëntë komunat e mëposhtme: Veles, Gradsko, Demir Kapi, Kavadarci, Lozovo, Negotino, Rosoman, Sveti Nikole dhe Çashka.



KËSHILLA RINORE LOKALE

Ky rajon ka formuar numrin më të madh të këshillave rinorë lokalë, me 4 nga 9 komuna. Në këtë rast, po flasim për komunat Veles, Gradsko, Negotino dhe Sveti Nikole.

STRATEGJI LOKALE PËR TË RINJ

Përkundër numrit të madh të këshillave rinore lokale në këtë rajon, asnjë komunë nuk ka miratuar një strategji lokale rinore.

NËPUNËSIT RINOR

Nga pikëpamja e shërbimeve rinore, ashtu si strategjitë, nuk ka asnjë zyrë rinore në asnjë komunë. Në ndryshim nga këto të dhëna, në 8 nga 9 komuna, u emërua një oficer rinor. E vetmja komunë që nuk ka emëruar një zyrtar rinor është komuna e Rosomanit.

ZYRAT RINORE

Nuk ka zyra për të rinjtë në këtë rajon,


QENDRA RINORE

Në këtë rajon, janë hapur dy qendra rinore, përkatësisht në komunat Veles dhe Kavadarci, dhe ato menaxhohen përkatësisht nga Fondacioni për Zhvillim Lokal dhe Demokraci "Fokus" dhe organizata partnere Skuadra e Skautëve "Dimitar Vlahov" - Veles (Komuna e Velesit), dhe Shoqata e të Rinjve - Kreativ - Shkup në partneritetet me Këshillin për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve - SPPMD (Komuna e Kavadarci).

FINANCIMI

Për sa i përket financimit në nivel lokal, komunat kanë detyrimin të ndajnë të paktën 0.1% të buxheteve të tyre vjetore.

Kur bëhet fjalë për komunat në rajonin e Vardarit, disa prej tyre u përgjigjën se meqenëse nuk kanë krijuar këshilla rinore lokale, zyra rinore dhe qendra rinore, ata nuk kanë ndarë mjete specifike. Vetëm Komuna e Velesit dhe Komuna e Sveti Nikollës kanë ndarë mjete për zbatimin e ligjit për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat rinore.





KONKLUSIONE

Zbatimi i Ligjit për Pjesëmarrje rinore dhe politika rinore në rajonin e Vardarit është në një nivel të ulët, me gjithsej 9 komuna, deri më tani janë emëruar 8 nëpunës rinor, janë hapur 2 qendra rinore, janë krijuar 4 këshillat rinorë lokalë, dhe ende nuk janë krijuar strategjitë lokale rinore dhe zyrat rinore;

Rajoni i Vardarit në veçanti dështon kur bëhet fjalë për ndarjen e mjeteve nga buxhetet komunale për zbatimin e dispozitave të Ligjit për Pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, duke pasur parasysh se nuk ka asnjë ndryshim nga 2022 në krahasim me atë të planifikuar për 2023.



REKOMANDIME

Zbatimi urgjent i dispozitave në Ligjin për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat rinore, veçanërisht në nivel komunal;

Profesionalizimi i nëpunësve për të rinjtë në mënyrë që të njihen konkretisht me kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre dhe të sigurohet qëndrueshmëria e kësaj pozite dhe jo rotacioni i saj ndërmjet punonjësve në institucion, përkatësisht komunë.

Krijimi dhe zbatimi i programeve për ngritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të Këshillave Rinorë lokalë dhe nëpunës rinorë.

Krijimi i manualeve për procedurat administrative për krijimin dhe menaxhimin e mekanizmave dhe shërbimeve në kompetencë të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale.

Vendosja e një zëri të posaçëm buxhetor për të rinjtë në buxhetet e komunave, me qëllim që të jenë transparentë dhe të përgjegjshëm ndaj të rinjve për mënyrën se si shpenzohen dhe nëse ndahen realisht mjetet e përcaktuara në ligj.

